



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT



Raport monitorues 17-të

mbi punën e legjislativit të komunës së
Lipjanit

Qershor 2018

Përmbajtja:

Hyrje,	Faqe 2
Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit	Faqe 3
Zgjedhjet lokale në Lipjan	Faqe 3
Përmbledhje ekzekutive	Faqe 5
Dinamika e punës së Kuvendit	Faqe 7
Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2018:	Faqe 7
Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë vitit 2018:	

Lista e tabelave:

Tabela krahasuese 1: E zgjedhjeve nga viti 2000 deri 2017	Faqe 4
Tabela krahasuese 2: Pjesëmarrja e gjinisë femërore në Kuvendin komunal të Lipjanit 2009/2017	Faqe 5
Tabela krahasuese 3: Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit gjatë 2015 - 2018	Faqe 7
Tabela 4: Pjesëmarrja e Deputeteve gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit	Faqe 10
Tabela 5: Renditja e deputeteve bazuar në angazhimet e tyre nëpër seanca plenare të Kuvendit të Lipjanit	Faqe 12
Tabela 6: Angazhimi i subjekteve politike gjatë seancave plenare të Kuvendit të Lipjanit	Faqe 12
Tabela krahasuese 7: Pjesëmarrja subjekteve politike në diskutime gjatë seancave	Faqe 13
Tabela krahasuese 8: Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Faqe 14
Tabela krahasuese 9: Pyetjet parlamentare	Faqe 14
Tabela krahasuese 10: Inicimi i çështjeve	

Lista e grafikoneve:

Grafiku 1. Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit	Faqe 8
Grafiku 2. Pjesëmarrja subjekteve politike në diskutime gjatë seancave	Faqe 13
Grafiku 3. Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Faqe 14
Grafiku 4. Pyetjet parlamentare	Faqe 14
Grafiku 5. Inicimi i çështjeve	Faqe 15

Adresa: Rr. "Tahir Sinani" 14000 Lipjan

Tel. +377 (0) 44 786 414

e-mail: info.yahr@gmail.com

Ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>

<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

Facebook: <https://www.facebook.com/YAHR.Kosovo>

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center"



Hyrje

Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ,gjatë periudhës katër vjeçare 2017/2021 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

Youth Association for Human Rights /YAHR që nga vitit 2009 është duke bërë monitorimin pro aktiv të punës së kuvendit të Komunës së Lipjanit. Në monitorimin e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për periudhën gjashtë mujore, nëpërmes këtij raporti YAHR provon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Komunës së Lipjanit, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, Kuvendin e Komunës së Lipjanit.

Raporti të shtatëmbëdhjetë monitorues për punën e legjislativit të Kuvendit komunal të Lipjanit, karakterizohet me zhvillime në interes të qytetareve. Me gjithë atë YAHR-i është munduar që të hartojë një raport, duke u mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të mediave të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

**Bekim Krasniqi
Drejtör ekzekutiv i YAHR-it**



Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit

YAHR në tentativë për të adresuar interesat dhe brengat të qytetarëve në mënyrë të paanshme dhe apartiake u ofron qytetarëve informata në mënyrë të vazhdueshme. Synimi i monitorimit të punës së zyrtarëve të zgjedhur është ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme demokratike.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t'iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave.

Zgjedhjet lokale në Lipjan

Kuvendi Komunal i Lipjanit i ka 31 ulëse. Në mandatin e parë dhe të gjashtë të qeverisës, shumica e vendeve në KK i ka takuar LDK-së. Dy vite më vonë, zgjedhjet e dyta lokale nxorën PDK-në si partinë më të madhe në këtë komunë. PDK fitoi 14 ulëse dhe së bashku me një përfaqësues të AAK qeverisën me komunën për pesë vite. Edhe në mandatin e tretë PDK kishte shumicën e ulëseve, edhe pse kishte një përfaqësues më pak. Edhe numri i votave për këtë subjekt politik kishte rënë në krahasim me zgjedhjet e vitit 2002. Humbjen më të madhe të votave në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007 e pësoi LDK, votat e së cilës u përgjysmuan.

Në zgjedhjet e 15 Nëntorit 2009, prapë udhëheqë PDK-ja si parti më e madhe në komunë me 12 deputet. Kemi një rritje të LDK-së në 9 deputet si pasojë e anulimit të rezultateve në Qendrën e votimit në Shalë. Kemi një ulje të LDD-së dhe AKR-së dhe një ngritje të AAK-së. Risi në këtë legjislaturë është hyrja e PSD-së me një deputet.

Ndërsa, në zgjedhjet e vitit 2013, prapë si parti me më shumë deputetet është PDK-ja me 10 deputet, por e ka humbur garën për zgjedhjen e kryetarit të komunës. Karakteristikë në zgjedhjet e vitit 2013 është koalicioni i gjerë i përbërë nga të gjitha partitë pjesëmarrëse në zgjedhjet 2013 (LDK-ë, AAK/LDD/IQL, AKR-ë), me përjashtim të Vetëvendosjes dhe PDK-së.

Në zgjedhjet e fundit të vitit 2017, kemi rikthim të LDK-së si partia me e madhe në Kuvendit komunal të Lipjanit me 12 deputet dhe kemi një rënie të PDK-së nga 10 në 6 deputet, sa i kishte në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Po ashtu kemi një ngritje të LVV-së nga 2 në 3 deputet. Në gjashtë legjislaturat e gjertanishme vetëm tri parti politike kanë arritur që të përfaqësohen vazhdimisht.

Në legjislaturën e dytë (2002-2007) kanë qenë të përfaqësuar edhe dy serbë nga dy parti të ndryshme politike. Kurse në legjislaturën e tretë (2007-2009) edhe komuniteti ashkali kishte siguruar një vend, kurse në legjislaturën e katër (2009-2013) nuk ka pasur asnjë deputet nga komunitetet pakicë dhe në legjislaturën e pestë dhe të gjashtë kemi një deputet nga komuniteti pakicë.

Tabela krahasuese 1: E zgjedhjeve nga viti 2000 deri 2017

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007		Zgjedhjet 2009		Zgjedhjet 2013		Zgjedhjet 2017	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	8317	13	10283	14	8925	13	7,926	12	8,601	10	5,338	6
LDK	10718	16	9923	13	4404	7	6,474	9	7,434	9	10,525	12
AAK	1109	2	840	1	929	1	1,036	2	-	-	2,321	3
LDD	-	-	-	-	1677	3	1,138	2	-	-	-	-
AKR	-	-	-	-	3007	5	2,652	4	2,047	2	2,193	3
ORA	-	-	-	-	746	1	477	1	-	-	-	-
PDAK	-	-	-	-	563	1	-	-	-	-	-	-
DCC	-	-	523	1	-	-	-	-	-	-	-	-
"Povratok"	-	-	391	1	-	-	-	-	-	-	-	-
PSD	-	-	-	-	-	-	847	1	643	1	-	-
Vetëvendosja	-	-	-	-	-	-	-	-	1,494	2	2,728	3
AAK/LDD/IQL	-	-	-	-	-	-	-	-	4,037	5	-	-
PD	-	-	-	-	-	-	-	-	432	1	443	1
G.I.SRPSKA	-	-	-	-	-	-	-	-	540	1	-	-
NISMA	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1,656	2
PAI	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	508	1

Tabela krahasuese 2: Pjesëmarrja e gjinisë femërore në Kuvendin komunal të Lipjanit 2009/2017

PJESËMARRJA E GJINISË FEMËRORE NË KUVENDIN KOMUNAL NË LIPJAN																							
Nr. ulëseve në asamble				Nr. femrave në asamble								Nr. deputeteve (femra) të zgjedhura pa kuotën e paraparë me ligje				Nr. Deputeteve të rizgjedhur							
2017	2013	2009	2007	2017	%	2013	%	2009	%	2007	%	2017	2013	2009	2007	2017	2013		2009		2007		
31	31	31	31	10	32.25	10	32.25	11	35.48	10	32.25	0	0	0	0	M	F	M	F	M	F	M	F
																8	1	3	3	10	9	5	6

Përmbledhje ekzekutive

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit “Qeverisja Lokale në Lipjan” bazuar në monitorimin e punës së Kuvendit komunal të Komunës së Lipjan gjatë periudhës Janar – Qershor 2018. Monitorimi është fokusuar në Asamblenë Komunale dhe organet tjera të këtij Kuvendit.

Në bazë të punës sonë monitoruese të drejtpërdrejtë dhe në bazë të vlerësimeve me anë të fletë notimit kemi konstatuar këto fakte:

- ✓ Legjislatura e re e Kuvendit Komunal të Lipjanit e dalur nga zgjedhjet lokale të vitit 2017 ka filluar punën me 12 Dhjetor 2018 me mbledhjen e parë inauguruese.
- ✓ Gjatë periudhës gjashtë mujore Janar-Qershor 2018 janë mbajtur katër seanca plenare nga ana e Kuvendit Komunal të Lipjanit. Ku kjo periudhë karakterizohet me një dinamikë të theksuar të marrjes së vendimeve dhe më pak shqyrtimesh të raportesh krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjatë kësaj periudhe janë aprovuar 26 vendime të propozuara nga ana e ekzekutivit dhe janë shqyrtuar 8 raporte apo informata nga institucionet e ndryshme përfshirë edhe policin, gjegjësisht stacionin policor në Lipjan.
- ✓ Organizata YAHR gjatë kësaj periudhe po ashtu ka bërë notimin e angazhimeve të deputeteve dhe të subjekteve politike në fusha të ndryshme duke përfshirë: diskutimet gjatë seancave, propozime për

rend dite, pjesëmarrjen e deputeteve në seanca, inicimin e çështjeve në interes të qytetareve dhe parashtrimin e pyetjeve të ndryshme nga ana e deputeteve drejtuar ekzekutivit.

- ✓ Si zakonisht subjektet politike nga opozita kanë qenë më të zëshëm në diskutime gjatë kësaj periudhe. Ku prin subjekti politik PDK me 40,12 % me pjesëmarrje në diskutime, LVV me 23.35 %, LDK me 14.37 %, AAK me 10.18 %, AKR me 5.39 %, PD me 4.19 % dhe NISMA me 2.40%.
- ✓ Gjatë kësaj periudhe kemi mbi 66 pyetje apo çështje të ngritura për problemet e qytetarëve, ku po ashtu prin subjektet politike opozitare. Tri subjekti politik të para që më së shumti që kanë bërë pyetje parlamentare janë PDK-ja me 52.17 %, LVV me 21.74%, LDK me 8.70 % etj. Ndërsa me çështje të ngritura në interes të qytetareve janë PDK 40 %, LVV 40 % dhe LDK 5%.
- ✓ Ndërsa, performancë më të mirë në diskutimet individuale kanë shefat e grupeve parlamentare ku prin Lulzim Rrustemi PDK 132 pikë, Selatin Retkoceri nga LVV me 112 pikë dhe Ramiz Qeriqi nga PDK me 109 pikë.
- ✓ Edhe gjatë kësaj periudhe kemi edhe 7 deputet memecë të cilët nuk kanë marrë fare pjesë në diskutime në katër seancat plenare.
- ✓ Është interesante krahasuar me legjislaturën e kaluar kemi një angazhim të theksuar dhe aktiv të pjesëmarrjes së deputeteve gra në diskutime për çështje të ndryshme. Ku më aktivja në diskutime është deputetja nga subjekti politik PDK-ë Lumturije Bytyqi Hasani me 74 pikë, pasuar nga Albulena Kelmendi LVV 74 pikë, Linda Shahini LDK 60 pikë, Hyra Bytyçi LDK 29 pikë, Anila Reçica Llugini LDK 14 pikë, Ganimete Qeriqi AAK 14 pikë, Egzona Fazlija NISMA 14 pikë, Safete Amerllahu AKR 9 pikë dhe Majlinda Sylejmani LDK me 6 pikë.

Rekomandimet:

- ✓ Një qasje konstruktive të kryesuesit të organit të Kuvendit Komunal ndaj të zgjedhurve të qytetareve,
- ✓ Një përgjegjësi më të madhe të deputeteve ndaj interesave të qytetareve dhe të mos harrohet se ata janë aty për të përfaqësuar interesat e qytetarëve, e jo interesat individuale apo edhe partiake.
- ✓ Ofrimin e përgjigjeve nga ana e ekzekutivit ndaj pyetjeve të parashtruar nga ana e deputeteve komunal,
- ✓ Harmonizimi i Statutit Komunal me (Nr. .110-623 i datës 26.09.2008) dhe ligjet aktuale në fuqi të Republikës së Kosovës, gjegjësisht me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave Nr. 03/L-041 të datës 20 shkurt 2008.

- ✓ Një opozitë me e zëshme për artikullimin e interesave të qytetareve karshi ekzekutivit të Komunës së Lipjanit,
- ✓ Dërgimin e materiale të Kuvendit për organizatat monitoruese,
- ✓ Delegatet e Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhen të jenë më aktivë dhe më efikas , e sidomos nëpër komitete.

Dinamika e punës së Kuvendit


Në këtë vit 2018 deri me tani janë mbajtur një seanca e rregull plenare dhe një e jashtëzakonshëm.. Ndërsa, po ashtu është mbajtur vetëm dy mbledhje të Komitetit për Politikë dhe financa. Nëse bëjmë një krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar është një gjendje e mirë e punës.

Tabela krahasuese 3: Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit gjatë 2015 - 2018

Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit

Raporte të shqyrtuara			Rregullore dhe plane komunale të miratuara			Vendime komunale të miratuara		
2015	2016	2018	2015	2016	2018	2015	2016	2018
5	10	3	5	7	5	24	41	26

Grafiku 1. Aktivitetet e punës së Kuvendit Komunal të Lipjanit



Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2018:

- *Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr. 011-70915 e datës 28. 12. 2016*
- *Rregullorja mbi transparencën.*
- *Informatë mbi gjendjen e sigurisë nga Policia e Kosovës të Lipjanit për vitin 2017,*
- *Raporti i buxhetit dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve, kategorive ekonomike dhe programeve për vitin 2017 për Komunën e Lipjanit ,*
- *Rregullore mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.*
- *Informatë mbi lokalet afariste që janë në pronësi të Komunës së Lipjanit.*
- *Raporti i punës i zyrës së Kryetarit dhe i drejtorateve komunale për vitin 2017*
- *Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për taksat komunale 15Nr.011-17239 të datës 05.04.2016*
- *Rregullore për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësor për fëmijët.*
- *Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Mars 2018*

Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë vitit 2018:

- *Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtëshme të Komunës,*
- *Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për ndërtimin e Xhamisë në Lipjan,*
- *Vendim për dhënien e pelqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan.*
- *Vendim për caktimin e lokacioneve për deponimin e mbeturinave nga ndërtimet dhe demolimet e tyre dhe groposjen e kafshëve të ngordhura.*
- *Vendim për dhënien e pelqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2016 dhe 2017 në vitin 2018.*
- *Vendim për fillimin e procedurave për ndarjen e banesave në pronësi të Komunës sipas programit komunal tre vjeçar për banim 2016-2019.*

- Vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.
- Vendim për ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë P-71409044-00846-10 nga P.SH shkolla bujqësore Lipjan në P.SH Kuvendi Komunal Lipjan për ndërtimin e tregut të gjelbër.
- Vendim për miratimin e planit të veprimit për transparencë në Komunë,
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndryshimin e segmentit rrugor “Bejtush Gërbeshi” në kuadër të zonës urbane lindore “ZUL-5” në Lipjan,
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë,
- Vendim për miratimin e nismës bashkisë së Frascineto nga Italia për binjakëzim ndërmjet komunave të Italisë Civita dhe Frascineto me komunat e Republikës së Kosovës Lipjanit dhe Fushë Kosovës.
- Vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës për përfaqësimin e Komunës së Lipjanit mbi vendosjen e bashkëpunimit komunal Ndërkombëtar,
- Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Llugaxhi.
- Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare shoqatës sindikale të administratës komunale.
- *Vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për hartimin e projektit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Lipjanit për periudhën 2018-2023 1Nr. 011-21737 të datës 10. 04. 2018*
- *Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan 1Nr.400-21581 të datës 10. 04. 2018.*
- *Vendim për fillimin e aktiviteteve për organizimin dhe mbajtjen e festivalit për fëmijë, me titull “Lipjani Këndon”*
- *Vendim për rregullimin e komunikacionit rrugor në disa rrugë të qytetit të Lipjanit,*
- *Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm për shpronësim të paluajtshmerisë për hapjen-ndërtimin e rrugëve “Bejtush Gërbeshi” dhe “Qamil Olluri” në Lipjan.*
- *Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Llugaxhi.*
- *Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme (lokaleve) të Komunës*
- *Vendim për ndërrimin e destinimit të tokës.*
- *Vendim për shpallje Z. Gani Demir Retkoceri qytetarë nderi i Komunës së Lipjanit,*
- *Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës të paluajtshme komunale,*

- Vendim për shkëputje të kontratës 1-464-3593 të datës 11.08.2011 për dhënien me qira të lokalit palujtshmerisë.

Pjesëmarrja e delegateve të Kuvendit në diskutime nga seanca 4-8, në bazë të fletë-notimit për se cilin deputet:

- Vërejtje: përkatësia e politike e deputeteve është bazuar vetëm në bazë të certifikimit nga ana e KQZ-së dhe lëvizjet e bëra të deputeteve në mes subjekteve politike në këtë raport nuk janë marrë parasysh.

Tabela 4: Pjesëmarrja e Deputeteve gjatë seancave plenare në Kuvendin e Komunës së Lipjanit

KOMUNA E LIPJANIT		Propozim për rend dite	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Inicimi i çështjeve	Amandamenti I legjislacionit	Inicimi I rregulloreve	Pyetjet parlamentare	Mungesa në seanca	Gjuha jo parlamentare	Gjithsej pike
Deputetët	Subjekti politik										
DIAMANT BYTYQI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
NAIM STULLCA / ARTON RETKOCERI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
DAUT AZEMI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
MEHMETALI KRASNIQI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
NEHAT TËRPEZA	LDK	0	20	1	0	0	0	0	0	0	21
FADIL SOPA	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
NAIM JAHIRI	LDK	0	4	0	0	0	0	5	0	0	9
RAMADUSH TASHOLLI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
HYRA BYTYÇI	LDK	0	16	8	0	0	0	5	0	0	29
LINDA SHAHINI	LDK	0	40	5	5	0	0	10	0	0	60
ANILA REÇICA LLUGIQI	LDK	0	12	2	0	0	0	0	0	0	14
MAJLINDA SYLEJMANI	LDK	0	4	2	0	0	0	0	0	0	6
LULZIM RRUSTEMI	PDK	0	92	0	15	0	0	25	0	0	132
RAMIZ QERIQI	PDK	0	64	0	10	0	0	35	0	0	109
ARGJENT TASHOLLI	PDK	0	12	0	5	0	0	25	0	0	42
NAZMI KRASNIQI	PDK	0	52	0	0	0	0	10	0	0	62
LUMTURIJE BYTYQI HASANI	PDK	0	44	0	10	0	0	20	0	0	74
EGZONA BYTYQI	PDK	0	4	0	0	0	0	5	0	0	9
SELATIN RETKOCERI	LVV	2	80	0	25	0	0	5	0	0	112

SHKELZEN BISLIMI	LVV	0	32	0	5	0	0	25	0	0	62
ALBULENA KELMENDI	LVV	0	44	0	10	0	0	20	0	0	74
AFRIM MIFTARI	AKR	0	32	2	0	0	0	0	0	0	34
HAJDIN BYTYQI	AKR	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
SAFETE AMERLLAHU	AKR	0	4	0	0	0	0	5	0	0	9
BASHKIM BUDAKOVA	AAK	0	8	1	0	0	0	5	0	0	14
UKË KRYEZIU	AAK	0	56	3	0	0	0	5	0	0	64
GANIMETE QERIQI	AAK	0	4	0	5	0	0	5	0	0	14
MANUSH SHAMOLLI	NISMA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
EGZONA FAZLIJA	NISMA	0	8	1	0	0	0	5	0	0	14
ARBEN SALIHU	PDK	0	28	0	5	0	0	0	0	0	33
FEHMI REXHEPI	PAI	0	0	0	5	0	0	10	0	0	15

TRENDI I DISKUTIMEVE

Gjatë periudhës Janar - Qershor 2018, pjesëmarrja në diskutime e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Lipjanit në lidhje me pikat e rendit të ditës është karakterizuar me një rritje krahasuar me vitet tjera.

Deputetet më aktivë të kësaj periudhe kanë qenë: LULZIM RRUSTEMI PDK 132 pikë, SELATIN RETKOCERI LVV 112 pikë, RAMIZ QERIQI PDK 109 pikë, LUMTURIJE BYTYQI HASANI PDK 74 pikë, ALBULENA KELMENDI LVV 74 pikë, UKË KRYEZIU AAK 64 pikë, NAZMI KRASNIQI PDK 62 pikë, SHKELZEN BISLIMI LVV 62 pikë, LINDA SHAHINI LDK 60 pikë, ARGJENT TASHOLLI PDK 42 pikë, AFRIM MIFTARI AKR 34 pikë, ARBEN SALIHU PDK 33 pikë, HYRA BYTYÇI LDK 29 pikë, NEHAT TËRPEZA LDK 21 pikë, FEHMI REXHEPI PAI 15 pikë, ANILA REÇICA LLUGIQI LDK 14 pikë, BASHKIM BUDAKOVA AAK 14 pikë, GANIMETE QERIQI AAK 14 pikë, EGZONA FAZLIJA NISMA 14 pikë, NAIM JAHIRI LDK 9 pikë, EGZONA BYTYQI PDK 9 pikë, SAFETE AMERLLAHU AKR 9 pikë dhe MAJLINDA SYLEJMANI LDK 6 pikë.



Deputete më pasivë të ashtuquajtur “Shikues” janë: DIAMANT BYTYQI LDK, NAIM STULLCA LDK, MEHMETALI KRASNIQI LDK, FADIL SOPA LDK, RAMADUSH TASHOLLI LDK, HAJDIN BYTYQI AKR dhe MANUSH SHAMOLLI NISMA të gjithë me 0 pikë.

Tabela 5: Renditja e deputeteve bazuar në angazhimet e tyre nëpër seanca plenare të Kuvendit të Lipjanit

Deputet aktivë dhe pasivë, me numrin e diskutimeve

	Deputeti	Subjekti politikë	pikët		Deputeti	Subjekti politikë	pikët
1	LULZIM RRUSTEMI	PDK	132	16	ANILA REÇICA LLUGIQI	LDK	14
2	SELATIN RETKOCERI	LVV	112	17	BASHKIM BUDAKOVA	AAK	14
3	RAMIZ QERIQI	PDK	109	18	GANIMETE QERIQI	AAK	14
4	LUMTURIJE BYTYQI HASANI	PDK	74	19	EGZONA FAZLIJA	NISMA	14
5	ALBULENA KELMENDI	LVV	74	20	NAIM JAHIRI	LDK	9
6	UKË KRYEZIU	AAK	64	21	EGZONA BYTYQI	PDK	9
7	NAZMI KRASNIQI	PDK	62	22	SAFETE AMERLLAHU	AKR	9
8	SHKELZEN BISLIMI	LVV	62	23	MAJLINDA SYLEJMANI	LDK	6
9	LINDA SHAHINI	LDK	60	24	DIAMANT BYTYQI	LDK	0
10	ARGJENT TASHOLLI	PDK	42	25	NAIM STULLCA	LDK	0
11	AFRIM MIFTARI	AKR	34	26	MEHMETALI KRASNIQI	LDK	0
12	ARBEN SALIHU	PDK	33	27	FADIL SOPA	LDK	0
13	HYRA BYTYÇI	LDK	29	28	RAMADUSH TASHOLLI	LDK	0
14	NEHAT TËRPEZA	LDK	21	29	HAJDIN BYTYQI	AKR	0
15	FEHMI REXHEPI	PAI	15	30	MANUSH SHAMOLLI	NISMA	0

Pjesëmarrja e subjekteve politike të Kuvendit në diskutime nga seanca 4-8, në bazë të fletë-notimit:

Tabela 6: Angazhimi i subjekteve politike gjatë seancave plenare të Kuvendit të Lipjanit

Subjekti politik		Propozim për rend dite	rend dite		Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave			Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve			Inicimi i çështjeve			Pyetjet parlamentare		
	LDK	0	0.00	%	24	14.37	%	18	69.23	%	1	5	%	4	8.70	%
	PDK	0	0.00	%	67	40.12	%	0	0.00	%	8	40	%	24	52.17	%
	LVV	1	100.00	%	39	23.35	%	0	0.00	%	8	40	%	10	21.74	%
	AKR	0	0.00	%	9	5.39	%	2	7.69	%	0	0	%	1	2.17	%
	AAK	0	0.00	%	17	10.18	%	4	15.38	%	1	5	%	3	6.52	%

Youth Association for Human Rights

NISMA	0	0.00	%	4	2.40	%	2	7.69	%	0	0	%	2	4.35	%
PD	0	0.00	%	7	4.19	%	0	0.00	%	1	5	%	0	0.00	%
PAI	0	0.00	%	0	0.00		0	0.00		1	5		2	4.35	

Grafiku 2. Pjesëmarrja subjekteve politike në diskutime gjatë seancave




Tabela krahasuese 7: Pjesëmarrja subjekteve politike në diskutime gjatë seancave

PDK	67 pikë	40.12	%
LVV	39 pikë	23.35	%
LDK	24 pikë	14.37	%
AAK	17 pikë	10.18	%
AKR	9 pikë	5.39	%
PD	7 pikë	4.19	%
NISMA	4 pikë	2.40	%
PAI	0 pikë	0.00	

Grafiku 3. Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve




Tabela krahasuese 8: Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve

LDK	18	69.23	%
AAK	4	15.38	%
AKR	2	7.69	%
NISMA	2	7.69	%
PDK	0	0.00	%
LVV	0	0.00	%
PD	0	0.00	%
PAI	0	0.00	%

Grafiku 4. Pyetjet parlamentare




Tabela krahasuese 9: Pyetjet parlamentare

PDK	24	52.17	%
LVV	10	21.74	%
LDK	4	8.70	%
AAK	3	6.52	%
NISMA	2	4.35	%
PAI	2	4.35	%
AKR	1	2.17	%
PD	0	0.00	%

Grafiku 5. Inicimi i çështjeve




Tabela krahasuese 10: Inicimi i çështjeve

PDK	8	40	%
LVV	8	40	%
LDK	1	5	%
AAK	1	5	%
PD	1	5	%
PAI	1	5	%
AKR	0	0	%
NISMA	0	0	%

Pyetjet parlamentare nga deputet gjatë periudhës raportuese:

Mbledhjes së 5-të:

Lulzim Rrustemi- njoftoi anëtarët e Kuvendit me peticionin e qytetarëve të fshatit Rubovc, Kojskë dhe Pojatë lidhur me emrin e shkollës që është duke u ndërtuar dhe kërkoj që t'i ndërrohet emri dhe shkolla ta merr emrin e atdhetarit Jonuz Emin Bajqinca. Ndërsa çështjen e dytë e ngriti lidhur me problemin me ujin e pijshëm të fshatit Medvec të dilet nuk ka furnizim me ujë të pijshëm dhe pyeti drejtorin për Shërbime Publike që të na njoftoj se çka është duke u bërë në këtë drejtim.

Linda Shahini- kërkoj nga ekzekutivi i komunës sa më parë të filloj ndarja e banesave për familjet në nevojë që sa më parë të sillet për aprovim në Kuvend, vendimi për ndarjen e banesave për familjet që kanë nevojë për strehim.

Selatin Retkoceri- ngriti disa çështje që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me jetën e qytetarëve siç ishin: respektimi i Ligjit për duhanin , rreth rrugës Janjevë –Lipjan, pastaj rruga regjionale Magurë-Lipjan. Kërkoj që të bëhet trysni tek Ministria si financuese e projekteve. Pastaj potencoj ndërtimin e trotuareve pa asnjë kriter, ku po krijohen mbeturina dhe po bllokohen rrugët prej tyre, gjithashtu problem i madh për qytetarë është mashtrimi nga ana e marketeve me çmime jo reale dhe me mallra të skaduar që po i dëmtojnë qytetarët.

Ramiz Qeriqi- propozoi dy kërkesa njëra lidhur me ujërat e zeza te nënkalimi në Krojmir i cili nuk është funksional dhe kërkoj që të ndërhyhet, ndërsa tjetra ka të bëjë me sheshin “Adem Jashari”.

Shkelzen Bislimi, ngriti shqetësimin e qytetarëve të Gadimes lidhur me përdorimin e narkotikëve në afërsi të shkollave dhe nga nxënësit dhe kërkoj nga drejtori i DKA-së që të merr masa lidhur me këtë fenomen. Ndërsa nga Kryetari i komunës kërkoj që të kërkon nga policia patrullimin sa më të madh rreth objekteve shkollore me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie si dhe organizimin e fushatave vetëdijësuese për këta të rinjë.

Lumturije Bytyqi-Hasani- ngriti dy çështje : njëra ka të bëjë me arsimin që ka të bëjë me punësimin e një roje në shkollën e mesme me vendim të këshillit të shkollës. Unë dua të dijë se sa është e drejtë dhe legjitime punësimi me një vendim të këshillit të shkollës. Ndërsa e dyta kishte të bëjë me deponin e krijuar në fshatin Shalë .

Ganimete Qeriqi- Kerkoi që formohet shërbimi i patronazhit në QKMF-ë ku të theksoi se për shkak të mos ekzistimit të këtij shërbimi, qytetarët po na vdesin pa e gëzuar këtë shërbim.

Albulena Kelmendi- Vëmendja më e madhe duhet t'i kushtohet problemit që e ceku Shkelzeni lidhur me përdorimin e narkotikëve në shkolla dhe jashtë tyre. Unë mendoj se duhet të diskutohet në një mbledhje të veçanta kjo problematikë sepse si komunë e vogël që jemi ka shumë përdorues. Tash së fundmi kemi psikolog në shkollë por mendoj se duhet të kemi edhe sociolog dhe atë me orar të plotë dhe të merren me nxënësit dhe problemet e tyre.

Mbledhjes së 6-të:

Shkelzen Bislimi: i ngriti dy shqetësime, këto ditë për produktet e mishit po dalin skandale dhe a ka inspektime shtesë gjatë këtyre ditëve . Shqetësimi i dytë ishte lidhur me rrugën Lipjan-Janjevë ku ka qenë në projekt në vitin e kaluar përse nuk është realizuar.

Egzona Fazliu- pat një propozim, për rregullimin e varrezave të martirëve në Hallaq .

Ramiz Qeriqi- Nuk ishte i kënaqur lidhur me përgjigjen e marr nga Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport lidhur me kërkesën për ndërtimin e një lapidari të Bashkim Krasniqit, po ashtu edhe me kërkesën e dytë për lapidarin e Adem Jasharit ku kishte kërkuar të vihen do shporta të mbeturinave.

Nazmi Krasniqi- ngriti çështjen e përfundimit emërtimeve të rrugëve.

Lumturije Bytyqi-Hasani- ngriti çështjen e një kërkesë të nënave të fëmijëve me autizëm në mungesë të një hapësirë janë të detyruar të shkojnë në Banullë. Është mirë që komuna të bëjë një zgjidhje pasi që në muajin prill është dita e autizmit. Po ashtu ngriti çështjen e problemit të lokaleve të lojërave të fatit dhe pyeti se si është e mundur që disa të hapen e të mbyllen, në bazë të legjislacionit në fuqi ju duhet t'i largoni këto kazino nga qyteti si që kanë vepruar disa komuna tjera.

Argjent Tasholli- Ka pasur shumë komente nga qytetarët e Gadimes për rrjetin e kanalizimit që nuk është përfunduar në disa lagje, po ashtu edhe për rrugën Egzoti 99, kur do të përfundoj trotuari, disa rrugë menjëherë kanë filluar gropat etj.

Lulzim Rrustemi- propozoi që shkolla “Adem Gllavica” të shndërrohet në objekt të kulturës pasi që shumë gjenerata kanë kaluar atje.

Safete Amerllahu- propozoi që kategorive të viktimat e dhunës familjare të ju bëhet një zgjidhje më e mirë dhe një mbështetje nga Komuna e Lipjani.

Albulena Kelmendi- ngriti një shqetësim personal se gjimnaz jemi në përfundim të mësimit dhe për mua shqetësim është se punojmë me nxënës dhe psikologu e kryen punën vetëm gjysmë orari për shkak të orëve shtesë, personi në fjalë ka marrë pushim të lehonisë dhe duhet të zëvendësohej mirëpo kjo deri tani nuk ka ndodh pse nuk është zëvendësuar.

Mbledhjes së 7-të:

Shkelzen Bislimi- ngriti problemin e deponisë ilegale të mbeturinave përgjatë rrugës Sllovi-Gadime, ndërsa shqetësimi i dytë në rrugët në fshatin Gadime ku janë vënë disa pengesa në rrugë dhe qytetarët kanë shumë ankesa për këto çështje.

Linda Shahini- ngriti çështjen e plaçkitjes kapakëve të pushtave të kanalizimit,

Selatin Retkoceri, kërkoi nga drejtoria inspeksionit të bëjë një kontroll më të shtuar nëpër marketet pasi që po ka shumë produkte të prishura të mykura etj.

Ramiz Qeriqi, tha se kanalizimi prapa Abejes është shumë keq, është mirë sa nuk është asfaltu të rregullohet, pastaj bëri pyetje pse një kazino herë mbyllet herë hapet.

Argjend Tasholli, tha se te ndërtimi i fushës te shkolla fillore e Gadimes, kalon mbi te tensioni i lartë i rrymës.

Arben Salihu, bëri opytje lidhur me zhurmën që po bëhet prej kafiterive të natës pas orës 11 të natës po na shkakton probleme dhe po detyroheni të thërrasim policinë, inspekcioni a ka marrë ndonjë veprim për këtë çështje.

Fehmi Rexhepi- në fshatin Medvec pa pastërtia është shumë e madhe, kërkoi nga komuna të na ndihmoj në pastrim pastaj ne do ta mirëmbajmë vetë. Po ashtu kemi edhe një lokal për të pame ku një tel i rrymës kalon mbi te kemi bërë kërkesë disa herë por nuk është ndërmarrë asgjë. Po ashtu kanalizimi në një lagje afër 200 metra nuk ka hyrë hiq.

Nazmi Krasniqi, pyeti se kur do të bëhen emërtimet dhe ri emërtimet e rrugëve pasi që po ka shumë kërkesa të qytetarëve. Po ashtu kam një kërkesë që kompania “Pastrimi” të ketë një alternativë për pastrim të mbeturinave gjatë vikendeve pasi që qytetarët në vikende më shumë po dalin jashtë qytetit dhe qentë endacak po i shkapërderdhin mbeturinat.

Ganimete Qeriqi, tha se po i përcjelli me kujdes shqetësimet e kolegëve në Kuvend me të cilat pajtohem edhe unë si që janë: droga nëpër shkolla, kazinot etj. Po ashtu po më pengon çështja e Xhamiave që po ndërtohen në oborret e shkollave edhe pse edhe unë vetë i përkas besimit Islam,

Lumturije Bytyqi-Hasani, komuna a ka marrë ndonjë veprim për qentë endacak, ose a ka ndonjë plan për këtë çështje pasi që ka shumë fëmijë që janë kafshuar nga qentë endacak..

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Janar – Qershor 2018.
2. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Janar –Qershor 2018
3. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit, Janar –Qershor 2018,.
4. Komunikatat për media të YAHR-it Janar –Qershor 2018.
5. Ekstraktet nga mbledhjet e Kuvendit Komunal , Janar –Qershor 2018,
6. <http://kk.rks-gov.net/lipjan/> .

